



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA KUKËS

### DREJTORIA PROJEKTEVE DHE RINISË

Nr. PL Prot.

Kukës me, 23.01.2024

#### **Lënda: Thirrje për plotësimin me anëtar të Këshillit Vendor Rinor**

Bashkia Kukës, Drejtoria e Projekteve dhe Rinisë shpall thirrjen e II për krijimin e Këshillit Vendor Rinor, i cili do të jetë një organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të Bashkisë. Ftohen të gjithë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë si dhe këshillat e nxënësve, të paraqesin kandidaturat potenciale për të qenë anëtarë të Këshillit Vendor Rinor.

\*Mirëpresim çdo aplikim deri më datë 09.02.2024 në adresën tonë email: [info@kukesi.gov.al](mailto:info@kukesi.gov.al) dhe [emiriola.velia@kukesi.gov.al](mailto:emiriola.velia@kukesi.gov.al) me subjektin "Aplikim për anëtar të KVR". Rikujtojmë se çdo aplikim që nuk përmbush kriteret e mëposhtme, nuk do të kualifikohet për fazën e mëtejshme.

*Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", si dhe duke u bazuar në projekt-vendimin e miratuar nga Këshilli Bashkiak Kukës nr. 21, datë 24.05.2021, "Për krijimin e Këshillit Vendor Rinor", "Për përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Strukturës të Këshillit Vendor Rinor".*

Këshilli Vendor Rinor Kukës ushtron kompetencat e mëposhtme:

- këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë;
- Mandati i anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor është 2-vjeçar, me të drejtë riemërimi;

KVR përbëhet nga 6 anëtar, nga të cilët të paktën, 3 (tre) duhet të përzgjidhen duke respektuar kuotat gjinore të përcaktuara në pikën 3 neni 2 të vendimit nr.21, datë 24.05.2021 të Këshillit Bashkiak "Për përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Strukturës të Këshillit Vendor Rinor" si më poshtë vijon:

- Kryetari i Bashkisë (kryetar i KVR-së);
- 3 (tre) përfaqësues nga organizata rinore dhe/ose për të rinjtë (anëtar të KVR-së);
- 2 (dy) anëtar të senateve të shkollave të mesme të bashkisë Kukës (anëtar të KVR-së);

*Vini re:* Kandidati për anëtar i Këshillit Vendor Rinor, përfaqësues i organizatave rinore/jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Të ketë dhënë kontribut/të ketë përvojë në fushën e politikave e rinore të paktën 2 vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo zhvillimin e nismave/aktiviteteve të ndryshme me qëllim intensifikimin e jetës së të rinjve;
2. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
3. Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjiore;
4. Të jetë nga mosha 15 deri në 29-vjeç;

\*Nëse mendoni se plotësoni kriteret për të qenë pjesë e Këshillit Vendor Rinor, ju lutem bashkëngjisni në aplikimin tuaj dokumentat e mëposhtme:

**1- Kandidati, përfaqësues i organizatës rinore dhe/ose për të rinjtë duhet të ngarkojë:**

1. Kërkesën për aplikim;
2. Curriculum Vitae, CV;
3. Fotokopje të dokumentave që vërtetojnë CV-në;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;

**2- Kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore duhet të ngarkojë:**

1. Kërkesën për aplikim;
2. Curriculum Vitae, CV;
3. Fotokopje të dokumentave që vërtetojnë CV-në;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
5. Letër motivimi;

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!*

**KRYETARI**  
**Albert HALILAJ**

